



# REAGO!

## TË DREJTAT TUA NUK DUHET TË JENË OBJEKT ABUZIMI!

Si të raportoni të paligjshme  
dhe sjellje joprofesionale  
ose sjellje të pahijshme



## ÇFARË PARAQET MEKANIZMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM MBI POLICINË?

Njësia për kontroll të brendshëm, hetime kriminale dhe standardet profesionale (NJKBHKSP) është **njësi e veçantë organizative** e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe mekanizëm i kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme që është përgjegjës për përcaktimin e dukurive të sjelljeve të paligjshme, joprofesionale dhe jokorrekte të nëpunësve të policisë në kryerjen e punëve policore, të zyrtarëve të autorizuar në kryerjen e detyrave dhe kompetencave të veçanta dhe në sjelljen e punonjësve të tjerë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Çdo qytetar që beson se të drejtat dhe liritë e tij janë **shkelur nga ndonjë** nëpunës policie, mund t'i drejtohet Njesisë për kontroll të brendshëm.

### KUR MUND TË DORËZINI PARASHTRESË NË NJËSINË E KONTROLLIT TË BRENDSHËM?

Mund të dorëzoni ankesë nëse besoni se:

- cenohen liritë dhe të drejtat tuaja;
- jeni viktimë e sjelljes së paligjshme dhe joprofesionale të policisë;
- ndiheni të ofenduar nga sjellja e nëpunësve të policisë;
- keni njohuri për sjellje korrupsioni dhe kriminale të nëpunësve të policisë.

## **ÇFARË ËSHTË SJELLJE E PALIGJSHME, JOPROFESIONALE DHE JOKORREKTE?**

**Veprim i paligjshëm**, në pajtim me Rregulloren e Njesisë për kontroll të brendshëm, është shpërdorimi ose tejkalimi i kompetencave që kanë punonjësit e MPB-së, si gjatë kryerjes së detyrave të tyre të punës, ashtu edhe gjatë zbatimit të procedurave standarde në punën e policisë, me të cilët kryejnë veprë të kundërligjshme që është përcaktuar me ligj si veprë penale, e cila është kryer gjatë kryerjes së një veprë zyrtare ose veprë penale jashtë shërbimit me përdorimin e kërcënimit të rëndë, forcës ose mjete shtrëngimi që rezulton me vdekje, lëndim të rëndë trupor, lëndim trupor, privim të paligjshëm nga liria, torturë dhe trajtime dhe dënime të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, ose veprime të tjera të paligjshme.

**Sjellja joprofesionale**, në pajtim me Rregulloren e Njesisë për kontroll të brendshëm, është sjellja e punonjësve në kundërshtim me rregullat, rregulloret dhe standardet profesionale që zbatohen në Ministri dhe në polici gjatë zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore përkatësisht mosrespektimi i standardeve dhe procedurave për veprimet e punonjësve gjatë kryerjes së detyrave të punës si dhe moskryerja e detyrave të punës në kuadër të kompetencave të njesisë organizative të caktuar në Ministri dhe në polici.

**Sjellja jokorrekte**, në pajtim me Rregulloren e Njesisë për kontroll të brendshëm, është sjellje e punonjësve në kundërshtim me dispozitat e Kodit të etikës policore dhe akteve nënligjore që i rregullojnë marrëdhëniet e ndërsjella të punonjësve në Ministri.

## **NË CILAT RASTE QYTETARËT NUK MUND TË KËRKOJNË NDIHMË NGA NJËSIA PËR KONTROLL TË BRENDSHËM?**

Është e rëndësishme që qytetarët të dinë se denoncimet për vepra penale dhe kundërvajtje (apo vepra të dënueshme) që NUK janë kryer nga nëpunësit e policisë raportohen në stacion policor dhe jo në Njësinë për kontroll të brendshëm.

## **CILAT JANË KOMPETENCAT E NJËSISË PËR KONTROLL TË BRENDSHËM?**

Njësia për kontroll të brendshëm (NJKBHKSP) vepron me qëllim të: (1) konstatimit të sjelljeve joprofesionale, të paligjshme dhe jokorrekte të punonjësve të Ministrisë së Punëve të Brendshme; (2) të sanksionimit të sjelljes së tillë; (3) parandalimit të sjelljes së tillë.

**Korniza ligjore që rregullon punën e Njësisë për kontroll të brendshëm përbëhet nga:**

- Ligji për Punë të Brendshme;
- Ligji për Policinë;
- Ligji për Procedurë Penale;
- Ligji për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik;
- Rregullat për kryerjen e detyrave të punës të NJKBHKSP;
- Kodi etik të sjelljes për punonjësit e MPB-së;
- Plani strategjik i MPB-së 2023-2025;
- Programi kundër korrupsionit;
- Programi i punës së NJKBHKSP;
- Plani për integritetin e MPB-së 2023-2025.

**Ndaj parashtresës së dorëzuar veprohet sipas Ligjit për Parashtresa dhe Propozime.**

# SI TË KËRKONI NDIHMË NGA NJËSIA PËR KONTROLL TË BRENDSHËM?

Nëse jeni ballafaquar me veprim joligjor dhe joprofesional dhe sjellje jokorrekte nga nëpunësit policor për çka konsideroni që të drejtat Tuaja dhe liritë janë cenuar, mund të dorëzoni parashtresë pranë Njesisë për kontroll të brendshëm.

Parashtresa mund të dorëzohet në mënyrë elektronike, nëpërmjet telefonit ose personalisht.

- në mënyrë elektronike, në adresën [prijavi\\_i\\_poplaki@moi.gov.mk](mailto:prijavi_i_poplaki@moi.gov.mk)
- nëpërmjet telefonit, në numrat 199 dhe 192
- personalisht, në procesverbal për parashtresë të dorëzuar gojarisht në stacionin më të afërt policor
- personalisht, në procesverbal për parashtresë të dorëzuar gojarisht në NJKBHKSP
- me shkrim, nëpërmjet arkivit të MPB-së

Nëse nuk jeni të sigurt nëse duhet të paraqisni parashtresë në Njësinë për kontroll të brendshëm, ose nëse keni nevojë për ndihmë me paraqitjen, mund t'i drejtoheni adresave të njëjtë më sipër për këshilla.





Parashtresa mund të dorëzohet në gjuhë të ndryshme nga gjuhët zyrtare të vendit, pas së cilës do të merrni përgjigje në të njëjtën gjuhë.

Njësia për kontroll të brendshëm është i obliguar të përgjigjet brenda 30 ditëve nga parashtresa e paraqitur me informacione për situatën e konstatuar, masat e mundshme të marra ose për gjendjen e denoncimit tuaj.





Nëse pretendimet në parashtresë nuk janë në kompetencën e Njesisë për kontroll të brendshëm, do të merrni udhëzim ku të drejtoheni.

Në pajtim me Ligjin për Propozime dhe Parashtrësia, nuk ka mundësi për ankesë në Njësinë për kontroll të brendshëm nëse konstatohet se parashtrësia është pa bazë. Nëse parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e parashtrësës, ai mund t'i drejtohet mekanizmave të jashtëm për kontrollin e punës së policisë, përkatësisht:

Avokati i Popullit – mekanizëm për kontroll civil

-  [www.ombudsman.mk](http://www.ombudsman.mk)
-  rr. "Maqedonia" nr.19, 1000 Shkup, tel: 02 3129 335
-  02 3129 335
-  [contact@ombudsman.mk](mailto:contact@ombudsman.mk)

Njësia e specializuar për hetimin dhe ndjekjen e veprave të kryera penale nga persona me kompetenca policore dhe pjesëtarë të policisë së burgjeve pranë Prokurorisë Themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit (PTHP NKOK)

-  [www.jorm.gov.mk](http://www.jorm.gov.mk)
-  Kërste Misirkov pn, 1000 Shkup
-  +389 (02)3298-288
-  [jorm@jorm.org.mk](mailto:jorm@jorm.org.mk)

## PËRSE ËSHTË E RËNDËSISHME TË PARAQITNI PARASHTRËSË?

Për shkak të qytetarëve: Për shkak të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut; të ndihen të sigurt dhe me dinjitet.

Për shkak të policisë: Që policia të mund të veprojë për të përmirësuar cilësinë e punës së saj dhe, në të njëjtën kohë, të përforcojë besimin e opinionit.

Džikot dengjen roviqe, te sine phagerde tumere nijamija thaj tromalipa policijatar, na numo so, arakhena korkori tumen thaj tumare dizutnen, numa vi sikavena kaj sijen samale dizutne thaj adalesar anena baš e lačheder sasoitnipe thaj maripe mamuj i korupcija.